



Republika e Kosovës - Republika Kosova  
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborna komisija za žalbe i molbe

**A NR. 96/2010**

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, në panelin e përbërë nga Muharrem Shala, kryesues, Fahredin Ymeri dhe Ymer Hoxha, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC) të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), paraqitur kundër kandidatit të pavarur Nevzat Hudaverdi, nga Prishtinë, për mos deklarimin e Raportit Financiar që kërkohet në bazë të nenit 40.5 dhe 119.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe në bazë të nenit 6.6 të Rregullës Zgjedhor nr. 12/2009, , në seancën e panelit të mbajtur me 01.03.2010, mori këtë:

#### **VENDIM**

Ankesa pranohet si e bazuar.

Kandidati i pavarur Nevzat Hudaverdi, nga Prishtinë dënohet me gjobë prej 200 (dyqind) euro, të cilën shumë është i detyruar që të paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

#### **ARSYETIMI**

KZAP më 25.01.2010 ka pranuar një ankesë nga ZRPPC të KQZ-së në të cilën theksohet se Kandidati i pavarur Nevzat Hudaverdi, nuk e ka dorëzuar Raportin e Deklarimit Financiar në këtë institucion, i cili kërkohet në bazë të Nenit 40.5 dhe 119.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe në bazë të nenit 6.6 të Rregullës Zgjedhore nr.12/2009.

Parashtruesi i ankesës konstaton se Kandidati i pavarur Nevzat Hudaverdi, nuk e ka sjell Raportin Financiar, që ka qenë deri më 31 Dhjetor 2009 për Raundin e parë (I).

#### **FAKTET**

Më 15.02.2010, KZAP i ka dërguar Kandidatit të pavarur Nevzat Hudaverdi, një kopje të ankesës së ZRPPC-së dhe i ka ofruar mundësi që të përgjigjet deri më 18.02.2010, në përfundim të orarit të punës së KZAP-it. Sekretariati i KZAP-it nuk ka pranuar ndonjë përgjigje nga Kandidati i pavarur Nevzat Hudaverdi deri në kohen e caktuar.

#### **ANALIZË**

Juridiksioni i KZAP për shqyrtimin e ankesës buron nga kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP (Ligji nr – 03/073) dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (Ligji nr 03/L-072).

Neni 40.1 (Kërkesat për Deklarim Financiar) të LZP-së, përcakton se: *çdo subjekt politik i certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje, dorëzon Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës së Subjektit, duke i përfshirë të gjitha degët dhe pjesët përbërëse të tij, për periudhën që fillon nëntëdhjetë (90) ditë para zgjedhjeve dhe me mbarim në ditën e zgjedhjeve. Raporti i Publikimit Financiar për Fushatën dorëzohet jo më vonë se dyzetë e pesë (45) ditë kalendrike pas ditës së zgjedhjeve.*

Në këtë kontekst, Kandidati i pavarur Nevzat Hudaverdi, ka qenë i detyruar në bazë të këtij ligji që të dërgoj Raportin Financiar për Raundin e Parë (I), jo më vonë se 31.12.2009 – gjë që nuk ka ndodhur, andaj pohimet e paraqitura nga parashtruesi i ankesës janë te bazuara.

Neni 120.1, pika c) - (Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve) të LZP-së, përcakton se: *në rast se KZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ligji ose e Rregullave Zgjedhore të KQZ-së mund të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik ose një organizatë vëzhguese në një vlerë deri në dyqind mijë euro (€ 200,000).*

Gjatë përcaktimit të shumës së përshtatshme për gjobitjen e ndonjë subjekti politik për ndonjë shkelje, KZAP ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë; dhe
- Masat, nëse ka pasur fare të tilla, të cilat janë ndërmarrë apo miratuar nga subjekti politik për të parandaluar shkelje të ligjeve përkatëse zgjedhore në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore të tij;
- Ndonjë rrethanë tjetër lehtësuese ose rënduese.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë**

A nr. 96/2010 më datën 01.03.2010



**Kryesuesi i Panelit**

**Muharrem Shala**